



BASHKIA MIRDITË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1918 Prot

Rrëshen, më 28.04.2026

Lënda: Njoftim!

KONSULTIMET PUBLIKE
PËR

“DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PUBLIK, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE OROSH, KTHELLË DHE SELITË”, BASHKIA MIRDITË

Titulli: Konsultim Publik, për projekt – vendimet si më poshtë vijon;

1. P/Vendim nr. **3860/2** prot i Kryetarit Bashkisë; “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor/kulloror subjektit; “Tete Albania Tunnel & Mining” Sha, në njësinë administrative Orosh, në administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë
2. P/Vendim nr. **1707/3** prot i Kryetarit Bashkisë; “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor/kulloror subjektit; “Tete Albania Tunnel & Mining” Sha, në njësitë administrative Kthellë & Selitë, në administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë

Propozuesi: Projekt-aktet janë propozuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë

Sqarime për projekt-aktet:

- ✓ Projekt-vendimi nr. 1707/3 prot, i Kryetarit të Bashkisë, së bashku me relacionin sqarues dhe raportin mbi studimin tekniko - ekonomik, përcaktojnë arsyet e paraqitura nga propozuesi i projekt-akteve, ku kërkohet; sipërfaqja e përgjithshme pyjore që shtrihet gjurma e projektit, është rreth 4.566 ha, e ndarë në:
 - 1) Gjurma e rrugës është rreth 2.58 ha, me gjatësi rreth 5 160 ml (5.16 km) dhe gjërësi mesatare rreth 5 m
 - 2) Gjurma e trasesë së linjës së tensionit të lartë është 1.365 ha, me gjatësi rreth 2 730 ml (2.73 km) dhe gjërësi mesatare rreth 5 m
 - 3) Venddepozitimin e dherave dhe inerteve është rreth 0.596 ha
 - 4) Vendkërkimi i mineralit të bakrit 0.025 ha
- ✚ Gjurma e projektit shtrihet tërësisht në fond pyjor/kulloror publik, n/ngastrat pyjore nr. 41a, 41b, 42a, 42b, 44a, 44b, 45b, 45c 46a, 46b, 47a, 48a, 61a & 61b, në ekonominë pyjore/kullorore, në ekonominë pyjore/kullorore Spaç, njësia administrative Orosh
- ✓ Projekt-vendimi nr. 1707/3 prot, i Kryetarit të Bashkisë, së bashku me relacionin sqarues dhe raportin mbi studimin tekniko - ekonomik, përcaktojnë arsyet e paraqitura nga propozuesi i projekt-akteve, ku kërkohet; sipërfaqja e përgjithshme pyjore që shtrihet gjurma e projektit, është rreth 1.095 ha, e ndarë në:

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

- 1) Gjurma e rrugës është rreth 0.966 ha, me gjatësi rreth 2 147 ml (2.147 km) dhe gjërësi mesatare 4.5 m
 - 2) Vende kërkim zbulim mineral bakri rreth 0.129 ha
- ✚ Gjurma e projektit shtrihet tërësisht në fond pyjor/kullësor publik, n/ngastrat pyjore nr. 88b, 88d & 89d, në ekonominë pyjore/kullësore, njësia administrative Selitë dhe n/ngasrat pyjore nr. 24b, në ekonominë pyjore/kullësore Perlat – Shebe, njësia administrative Kthellë

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do të realizohet në përputhje me grafikun e konsultimit, pjesë e këtij njoftimi

Pjesëmarrës:

Nga ana e administratës dhe Këshillit Bashkiak: Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Shëndetit Publik, Menaxhimi i Ujrave, Mbrojtjes Mjedisit dhe Biodiversitetit, Këshilltarët, Agjencia e Bujqësisë & Administrimit të Pyjeve, Drejtoria Juridike, Koordinatori për Njoftim dhe Konsultimit Publik, Njësitë Administrative respektive; Orosh, Kthellë, Selitë dhe subjekti “Tete Albania Tunnel & Mining” Sha.

Platforma: Takim Publik

Nga komuniteti: Qytetarë, Kryetarët e Strukturave Komunitare (fshatrave), organizatat e Shoqërisë Civile, Media, dhe Komuniteti i Biznesit, bordet e prinderve etj.

Të nderuar qytetar!

Në mbështetje të nenit 18, dhe të nenit 54, shkronja (e), të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neneve, 6, 11, 15 dhe 18, të ligjit nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Rregullores “Për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Median (Konsultimet)”. Bashkia Mirditë fton qytetarët, fermerët, bizneset, shoqërinë civile të marrin pjesë në procesin e diskutimeve dhe konsultimeve publike duke shprehur mendimet apo sugjerimet e tyre në njësitë administrative të Bashkisë ku përfshihen projektet, sipas grafikut si më poshtë vijon;

Ju Mirëpresim !

GRAFIKU I KONSULTIMEVE				
Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi i takimit	Përshkrim
OROSH	13. 05. 2026	11:00	Njësia Administrative Orosh	Takim me banorët e Njesisë Admin. Orosh, kryetarët e fshatrave dhe palët e interesuara
SELITË	14. 05. 2026	10:00	Njësitë Administrative Selitë	Takim me banorët e Njesisë Admin. Selitë, kryetarët e fshatrave dhe palët e interesuar
KTHELLË	15. 05. 2026	11:00	Njësitë Administrative Kthellë	Takim me banorët e Njesisë Admin. Kthellë, kryetarët e fshatrave dhe palët e interesuar

Konc. Sekretar i Këshillit Bashkiak
Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Aleksandër PICAKU



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al